ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nënit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Kuvendi Komunal Lipjan**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **613-26-7442-2-1-1**

Sa i përket tenderit për*:* **Sigurimi fizik dhe alarme të institucioneve komunale – Ritenderim**

A N K E S Ë

---

1. Identifikimi i Ankuesit

SKYFTERAT-LIVE SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR.REXHEP BISLIMI NR.1
(Adresa)

FERIZAJ **70 000**
(Vendi) *(Kodi postar)*

048/100-800 **NUK APLIKOHET**
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

NJAZI SYLA
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

skyfterat-live@hotmail.com
(Adresa elektronike)

09.11.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me <u>PROKURË.</u>

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Lënda: *Shërbime*
Procedura e prokurimit: *Procedurë e hapur*
FPP fjalori kryesor: *75222000-8 Shërbimet civile te mbrojtjes*
Vlera e parashikuar: *320,000.00€ (e madhe)*

B05 Njoftimi për Kontratë
Data 07.09.2026

Afati për dorëzimin e tenderëve:
Data: 02.10.2026 – Ora: 14:00

Njoftimi mbi vendimin e AK-së:
Data: 23.10.2026

Kriteri për dhënien e kontratës:
√ Çmimi më i ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒ **X**

Jo, nuk kemi marr pjesë, hapja e aktivitetit të prokurimit është bërë në mënyrë elektronike përmes platformës së E-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ X **Jo** ☐

Po, jemi njoftuar përmes njoftimit mbi vendimin e AK-së.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Konform dispozitës Neni 108/A të LPP-së në afatin e lejuar ligjor kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim nëpërmjet platformës së E-prokurimit, AK-ja e ka bërë refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Legjislacioni primar -

1. Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

- Neni 1 - Qëllimi,
- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti,
- Neni 7 - Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi,
- Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës,
- Neni 28 - Specifikimet teknike,
- Neni 31 - Ekzekutimi i kontratave,
- Neni 51 - Njoftimi i kritereve të përzgjedhjes,
- Neni 52 - Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës,
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

- Legjislacioni sekondar –

2. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

- Neni 25 - Kriteret e përzgjedhjes,
- Neni 27 - Kriteret e dhënies së kontratës,
- Neni 38 - Sqarimi i Tenderëve,
- Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,
- Neni 41 - Tenderët Jo-normalisht të Ulët,
- Neni 45 - Procedura e Hapur.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

ANKESË

Të nderuar,

Në mbështetje të nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar, si dhe dispozitave përkatëse të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, paraqesim këtë ankesë, duke kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës sonë dhe rekomandimin për dhënie të kontratës Grupit të Operatorëve Ekonomikë MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A.

Konsiderojmë se vendimi i kontestuar është rezultat i një procesi të mangët dhe jo të kujdesshëm të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, në kundërshtim me detyrimet që burojnë nga neni 59 i LPP-së, veçanërisht paragrafi 59.4, si dhe me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe mosdiskriminimit të përcaktuara në nenin 7 të LPP-së.

Për më tepër, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka aplikuar standarde të ndryshme të vlerësimit ndaj operatorëve pjesëmarrës, duke eliminuar ofertën tonë **për dokumente që tashmë ishin dorëzuar** dhe duke iu shmangur përgjigje për ekzsitencën e këtyre dokumenteve e sidomos deklaratës për të cilën ka pretenduar se nuk e kemi, ndërsa njëkohësisht ka rekomanduar për kontratë një grup operatorësh ekonomikë për të cilin ekzistojnë dyshime serioze dhe të argumentuara lidhur me përmbushjen e disa kritereve të detyrueshme të dosjes së tenderit.

Për këto arsye, paraqesim pretendimet tona si në vijim.

I. PRETENDIMI I PARË – ELIMINIMI I PABAZUAR I OFERTËS SONË DHE MOSZBATIMI I NENIT 59.4 TË LPP-SË

Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, të datës 23.10.2026, Autoriteti Kontraktues ka dhënë këtë arsyetim:

"Tenderi juaj është refuzuar për arsye se ju mungojnë dëshmitë adekuate, përkatësisht ju mungojnë Certifikata/leje valide nga Autoriteti Përgjegjës (MPB) për tre punëtor si dhe ju mungon edhe **Deklarata për respektimin e Ligjit të Punës**."

Ky konstatim është i pasaktë dhe nuk pasqyron përmbajtjen reale të dokumentacionit të dorëzuar me ofertën tonë.

Kompania jonë ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, përfshirë dëshmitë për punëtorët dhe dokumentet përkatëse të MPB-së, si dhe deklarimin për respektimin e legjislacionit në fuqi.

Këto dokumente gjenden në ofertën tonë, përkatësisht në dokumentet elektronike të emërtuara:

1. "12.Lista e punëtorëve me kontrata"

Në këtë dokument janë paraqitur të dhënat dhe dëshmitë përkatëse të personelit të angazhuar, përfshirë dokumentacionin e kërkuar për punëtorët e sigurimit.

2. "7.Specifikimet teknike"

Në faqen nr. 2 të këtij dokumenti, të datës 02.10.2026, kompania jonë ka deklaruar shprehimisht:

"Kompania jonë deklarohet se do ti rrespektoj të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore dhe të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës."

Ky deklarim është pjesë e dokumentacionit të ofertës sonë dhe është paraqitur në mënyrë të theksuar. (**bashkangjitur gjeni dëshmitë**).

Rrjedhimisht, konstatimi se deklarata për respektimin e Ligjit të Punës mungon nuk mund të qëndrojë pa një analizë të qartë të përmbajtjes së dokumentit të dorëzuar.

Sipas nenit 59 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues ka detyrim që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve ta realizojë në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Neni 59.4 duhet të zbatohet duke vlerësuar përputhshmërinë reale të ofertës me kërkesat e dosjes, jo duke nxjerrë përfundime të pambështetura se një dokument mungon, kur ai është pjesë e dokumentacionit të dorëzuar.

Autoriteti Kontraktues dhe komisioni vlerësues kanë pasur për detyrë të shqyrtojnë të gjitha dokumentet e ngarkuara, përmbajtjen e tyre dhe dëshmitë që ato përmbajnë.

Mungesa e një shqyrtimi të kujdesshëm nga komisioni vlerësues nuk mund t'i atribuohet si mangësi operatorit ekonomik dhe as të përdoret si bazë për eliminimin e ofertës së tij.

Është e papranueshme që një operator ekonomik të eliminohet me arsyetimin se nuk ka dorëzuar dokumente, ndërkohë që këto dokumente gjenden në ofertën elektronike dhe kanë qenë të qasshme për komisionin vlerësues.

Një praktikë e tillë ngre dyshime serioze lidhur me mënyrën se si është kryer vlerësimi, kujdesin profesional të treguar nga komisioni dhe respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë procesin e prokurimit publik.

Për të shmangur çdo paqartësi, dokumentet në fjalë po i bashkëngjisim edhe një herë kësaj kërkese, duke theksuar se ato nuk paraqesin dëshmi të reja të krijuara pas afatit të dorëzimit, por dokumente që, sipas regjistrimit të ofertës sonë, kanë qenë pjesë përbërëse e saj.

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të verifikojë dokumentet origjinale të ngarkuara në platformën elektronike, përfshirë përmbajtjen dhe kohën e dorëzimit të tyre.

Nëse Autoriteti Kontraktues vazhdon të pretendojë se dokumentet mungojnë, kërkojmë të identifikojë saktësisht dokumentin, punëtorin përkatës, kërkesën e dosjes së tenderit dhe arsyen konkrete përse dëshmia e dorëzuar nuk është konsideruar e vlefshme.

II. PRETENDIMI I DYTË – MOSRESPEKTIMI I PARIMIT TË TRAJTIMIT TË BARABARTË DHE VLERËSIMI JO I NJËTRajtSHËM I OFERTAVE

Neni 7 i LPP-së përcakton detyrimin e Autoritetit Kontraktues për trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë.

Në këtë aktivitet prokurimi, Autoriteti Kontraktues ka publikuar disa vendime dhe sqarime shtesë lidhur me kërkesat e dosjes së tenderit, përkatësisht:

- 09.09.2026, ora 13:46 – Vendimi i AK-së për sqarime shtesë 1.pdf;
- 09.09.2026, ora 13:46 – Vendimi i AK-së për sqarime shtesë 2.pdf;
- 11.09.2026, ora 15:14 – Vendimi i AK-së – Sqarime shtesë.pdf;
- 14.09.2026, ora 15:41 – Vendimi i AK-së – Kërkesa për sqarim.pdf;
- 18.09.2026, ora 15:19 – Vendimi i AK-së – Sqarime shtesë.pdf.

Publikimi i këtyre sqarimeve tregon se gjatë zhvillimit të aktivitetit ka pasur kërkesa të shumta për interpretimin dhe sqarimin e kushteve të tenderit.

Megjithatë, pavarësisht sqarimeve të dhëna, Autoriteti Kontraktues ka qenë i detyruar të zbatojë në mënyrë të njëjtë kërkesat përfundimtare të dosjes ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Nuk mund të konsiderohet vlerësim i ligjshëm një proces në të cilin dokumentet ekzistuese të një operatori ekonomik nuk merren parasysh, ndërsa ndaj operatorit të rekomanduar nuk zbatohet i njëjti nivel kontrolli dhe verifikimi.

Kërkojmë që të verifikohet nëse komisioni vlerësues ka aplikuar standarde identike të shqyrtimit për të gjithë ofertuesit dhe nëse vendimet e tij janë të mbështetura në dokumente konkrete dhe jo në konstatime të përgjithshme.

III. PRETENDIMI I TRETË – MOSPËRMBUSHJA E KËRKESËS PËR CERTIFIKATAT ISO NGA GRUPI I REKOMANDUAR PËR KONTRATË

Në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 dhe 9.2, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar:

Kërkesa 4:

"Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë (në lëminë e sigurimit fizik), ISO 9001:2015, ISO 14001:2015."

Dëshmi 4:

"Të dëshmohet me certifikata të lëmisë së sigurimit fizik, valide 9001:2015, 14001:2015. Certifikatat duhet të jenë me validitet. Në rast të konzorciumit, mundet vetëm njëri OE ta plotësojë këtë dëshmi."

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues nuk ka qenë thjesht posedimi formal i certifikatave ISO, por posedimi i certifikatave që mbulojnë **fushën e veprimtarisë së sigurimit fizik**.

Sipas dokumentacionit që kemi pasur mundësi të shqyrtojmë, certifikatat e paraqitura nga anëtarët e grupit të rekomanduar, MEB L.L.C. dhe KSF MAJOR SH.A., nuk dëshmojnë mbulimin e fushës së sigurimit fizik sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Përmbushja e këtij kriteri nuk mund të konstatohet vetëm mbi bazën e titullit ISO 9001:2015 ose ISO 14001:2015, pa u shqyrtuar **fusha e certifikimit**, vlefshmëria, subjekti i certifikuar dhe aktivitetet që mbulon certifikata.

Duke qenë se dosja ka lejuar që vetëm njëri anëtar i grupit ta përmbushë këtë kërkesë, komisioni vlerësues ka pasur detyrim të verifikojë nëse të paktën njëri prej tyre posedon certifikatat me fushëveprimtarinë e kërkuar.

Në mungesë të një dëshmie të tillë, grupi i rekomanduar nuk mund të konsiderohet se ka përmbushur kërkesën nr. 4.

Kërkojmë verifikimin e certifikatave origjinale, anekseve të tyre, fushëveprimit të certifikimit dhe vlefshmërisë në datën përkatëse të dorëzimit të ofertave.

IV. PRETENDIMI I KATËRT – ANALIZA FINANCIARE E GRUPIT TË REKOMANDUAR NUK DËSHMON PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE LIGJORE NDAJ PUNËTORËVE

Në dosjen e tenderit, përkatësisht në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, është përcaktuar:

Kërkesa 2:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se gjatë realizimit të kontratës do të respektojë legjislacionin në fuqi, vendimin e Qeverisë për pagën minimale dhe të gjitha detyrimet ligjore, kontributet dhe kompensimet e punëtorëve.

Deklaratës duhet t'i bashkëngjitet analiza financiare me të gjitha llogaritjet.

Dëshmi 2:

Analiza financiare duhet të jetë e vulosur dhe e nënshkruar dhe të përfshijë pagën bazë të punëtorëve, detyrimet ligjore, kontributet dhe kompensimet përkatëse, me llogaritje sipas pozicioneve të kërkuara.

Gjithashtu, në Aneksin 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme, është kërkuar respektimi i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Vendimit të Qeverisë Nr. 10/273 të datës 31.10.2025, si dhe legjislacionit për shërbimet private të sigurisë.

Kjo kërkesë është e qartë dhe nuk mund të përmbushet vetëm përmes një deklarate formale.

Analiza financiare duhet të dëshmojë se operatori ekonomik ka paraparë shpenzimet e nevojshme për realizimin e shërbimeve në përputhje me detyrimet ligjore.

Në këtë drejtim, neni 56 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 përcakton të drejtat e punëtorëve për paga shtesë, përfshirë kategoritë përkatëse të punës jashtë orarit, punës gjatë natës, punës gjatë festave dhe punës gjatë fundjavës.

Në veçanti, duhet të shqyrtohet përfshirja e shtesave të përcaktuara ligjërisht, përfshirë:

- Punën gjatë natës – 30%;
- Punën jashtë orarit – 30%;
- Punën gjatë festave – 50%;
- Punën gjatë fundjavës – 50%.

Llogaritja duhet të bëhet mbi bazën e orëve reale të shërbimit, organizimit të ndërrimeve, ditëve të punës dhe kërkesave të pozicioneve të përcaktuara në specifikimet teknike, duke shmangur llogaritjen e dyfishtë të shtesave kur kjo nuk lejohet nga ligji.

Sipas vlerësimit tonë, analiza financiare e paraqitur nga grupi i rekomanduar nuk pasqyron në mënyrë të saktë dhe të plotë shpenzimet që burojnë nga këto detyrime.

Për këtë arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të verifikojë secilin pozicion të analizës financiare, përfshirë pagën bazë, kontributet pensionale, orët e natës, fundjavat, festat, zëvendësimet e punëtorëve gjatë pushimeve dhe detyrimet e tjera të zbatueshme.

Nëse analiza financiare nuk i përfshin këto detyrime, ose i përfshin në mënyrë të pasaktë, atëherë ajo nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit.

Një ofertë nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme nëse dokumentacioni financiar i kërkuar shprehimisht nuk dëshmon përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

V. PRETENDIMI I PESTË – DYSHIMET E ARSYESHME LIDHUR ME REALIZUESHMËRINË E OFERTËS FINANCIARE

Nga njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, rezultojnë këto vlera:

Operatori ekonomik	Vlera e ofertës
GOE MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A.	231,192.00 €
Internat Security Association SH.P.K.	255,165.12 €
Security Code	259,529.01 €
BESA SECURITY SH.P.K.	262,463.04 €
Delta Security SH.P.K.	283,109.76 €
SKYFTERAT–LIVE SH.P.K.	315,613.44 €

Nga këto të dhëna vërehet se oferta e grupit të rekomanduar është 23,973.12 € më e ulët se oferta e dytë më e lirë dhe 84,421.44 € më e ulët se oferta jonë.

Këto diferenca, të shqyrtuara në raport me natyrën e kontratës, numrin e punëtorëve, kohëzgjatjen e shërbimit dhe detyrimet ligjore, krijojnë bazë të arsyeshme për të kërkuar verifikim të hollësishëm të analizës financiare.

Theksojmë se një çmim më i ulët, në vetvete, nuk përbën shkelje ligjore dhe nuk është bazë automatike për eliminim.

Megjithatë, kur dosja e tenderit kërkon analizë të detajuar financiare, Autoriteti Kontraktues ka detyrim të verifikojë nëse ajo është e plotë, e saktë dhe në përputhje me detyrimet ligjore.

Në këtë kontekst, kërkojmë shqyrtimin e zbatueshmërisë së nenit 61 të LPP-së, që rregullon trajtimin e tenderëve me çmime jonormalisht të ulëta, si dhe dispozitave përkatëse të Rregullores Nr. 001/2022.

Autoriteti Kontraktues duhet të sqarojë nëse ka analizuar çmimin e ofertuesit të rekomanduar, nëse ka identifikuar nevojën për sqarime dhe nëse ka verifikuar mundësinë reale të realizimit të kontratës në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore.

Nuk është e mjaftueshme që oferta të jetë më e lira; ajo duhet së pari të jetë e përgjegjshme dhe e realizueshme sipas kushteve të përcaktuara në dosjen e tenderit.

VI. PRETENDIMI I GJASHTË – MOSPËRMBUSHJA E KËRKESËS PËR PERSONELIN MENAXHUES DHE LICENCAT PROFESIONALE

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kërkesën që operatori ekonomik të caktojë:

a) Një menaxher të projektit, me vendim, i cili ka përvojë pune minimum pesë vite në menaxhim;

b) Një person të certifikuar dhe të licencuar nga MPB-ja si menaxher i sigurimit për shërbimet themelore të sigurimit;

c) Operatorin ekonomik ose një anëtar të stafit të licencuar nga MPB-ja për shërbimet e specializuara të vëzhgimit elektronik të pronës.

Për përmbushjen e këtyre kërkesave janë kërkuar CV-ja, referencat e përvojës së punës, **certifikatat** dhe **licencat përkatëse**.

Sipas dokumenteve që kemi pasur mundësi të shqyrtojmë, ekzistojnë mospërputhje lidhur me përvojën profesionale të personelit të paraqitur nga grupi i rekomanduar.

Në veçanti, certifikata dhe kartela e MPB-së për personin e paraqitur në funksionin e menaxherit **nuk dëshmojnë përvojën minimale pesëvjeçare të kërkuar** në menaxhim.

Në këtë pikë kërkohet një dallim i qartë ndërmjet posedimit të një licence profesionale dhe dëshmimit të përvojës së punës në menaxhim.

Certifikata e MPB-së tregon qartazi se kur është certifikuar personi i caktuar për Menaxher i Shërbimit Themelor, dhe kjo tregon se i njejti nuk e posedon këtë certificate ku tregohet se është lëshuar 5 vite më parë.

Nëse grupi i rekomanduar ka paraqitur të njëjtin person për më shumë se një funksion, komisioni vlerësues duhet të verifikojë përmbushjen e secilës kërkesë veçmas.

Gjithashtu, nëse përvoja e kërkuar nuk dëshmohet nga CV-ja, referencat dhe dokumentet e tjera të pranueshme, atëherë kriteri nuk mund të konsiderohet i përmbushur vetëm për shkak të posedimit të certifikatës së MPB-së.

Kërkojmë verifikimin e:

1. Vendimit për caktimin e menaxherit të projektit;
2. CV-së dhe referencave që dëshmojnë përvojën minimale pesëvjeçare në menaxhim;
3. Certifikatës dhe licencës së menaxherit për shërbimet themelore të sigurimit;
4. Licencës për shërbimet e specializuara të vëzhgimit elektronik të pronës;
5. Vlefshmërisë dhe përputhshmërisë së të gjitha dokumenteve me kërkesat e dosjes së tenderit.

Në mungesë të këtyre dëshmive, oferta e grupit të rekomanduar nuk mund të konsiderohet se i përmbush kërkesat përkatëse teknike dhe profesionale.

VII. PRETENDIMI I SHTATË – KUFIZIMI I PALIGJSHËM I QASJES NË DOKUMENTACIONIN E OPERATORIT TË REKOMANDUAR

Një çështje tjetër serioze që kontestojmë është mënyra se si Autoriteti Kontraktues ka trajtuar kërkesën tonë për qasje në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Pavarësisht kërkesës sonë, nuk na është mundësuar qasje e plotë në dokumentet relevante të ofertës, duke na kufizuar edhe mundësinë e shqyrtimit fizik të dokumentacionit.

Një kufizim i tillë cenon transparencën e procesit dhe vështirëson ushtrimin efektiv të së drejtës për kundërshtimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues.

Sipas nenit 7.6.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, dispozitës së cituar në këtë kërkesë, zyrtari i prokurimit, pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58), duhet të ofrojë qasje të menjëhershme në dokumentacionin përkatës sipas kërkesës së operatorit ekonomik.

Gjithashtu, dispozitat e LPP-së lidhur me transparencën dhe mbrojtjen e informatave konfidenciale kërkojnë që kufizimet e qasjes të kenë bazë ligjore dhe të mos shtrihen përtej informacionit që gëzon mbrojtje të ligjshme.

Nëse operatori i rekomanduar ka kërkuar trajtimin konfidencial të dokumenteve të caktuara, Autoriteti Kontraktues duhet të shqyrtojë bazueshmërinë e një kërkese të tillë.

Vetëm ekzistenca e një kërkese për konfidencialitet nuk e arsyeton automatikisht refuzimin e qasjes në të gjithë dokumentin.

Për dokumentet që përmbajnë të dhëna të mbrojtura, kërkojmë që të na ofrohen versionet e pastruara, me mbulimin e pjesëve që ligjërisht duhet të mbeten konfidenciale, duke ruajtur qasjen në informacionin tjetër.

Në veçanti, kërkojmë qasje në dokumentet që dëshmojnë përmbushjen e kritereve të dosjes së tenderit, përfshirë certifikatat ISO, analizën financiare, dëshmitë e personelit menaxhues, licencat dhe dokumentet e tjera relevante, në masën që lejohet nga ligji.

Kufizimi i pajustifikuar i qasjes nuk mund të përdoret për ta penguar një operator ekonomik që të identifikojë shkeljet eventuale dhe të ushtrojë mjetet juridike në afatet e përcaktuara.

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të na ofrojë menjëherë qasje në dokumentacionin e lejuar dhe të japë arsyetim të veçantë ligjor për çdo dokument ose pjesë të dokumentit për të cilën refuzohet qasja.

VIII. PRETENDIMI I TETË – MOSRESPEKTIMI I DETYRIMEVE QË BUROJNË NGA VENDIMMARRJA E MËPARSHME E OSHP-SË

Theksojmë se ky aktivitet prokurimi është zhvilluar si ritenderim, pas procedurave të mëparshme dhe vendimmarrjes së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Sipas rrethanave të njohura për kompaninë tonë, aktiviteti i mëparshëm është anuluar pas konstatimeve lidhur me mosrespektimin e kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, si dhe mangësive në vlerësimin e ofertave.

Kjo rrethanë duhet ta kishte shtyrë Autoritetin Kontraktues të tregonte kujdes të shtuar gjatë zhvillimit të procedurës së re.

Vendimet e OSHP-së, në masën që janë të zbatueshme për çështjet konkrete, duhet të merren parasysh nga Autoriteti Kontraktues dhe të respektohen në procesin e vlerësimit.

Përsëritja e mangësive të njëjta ose të ngjashme në një procedurë të re ngre shqetësime serioze për ligjshmërinë dhe cilësinë e procesit të prokurimit.

Kërkojmë poashtu që sqarojë Autoriteti Kontraktues se si janë trajtuar konstatimet e vendimit të mëparshëm të OSHP-së dhe cilat masa janë ndërmarrë për të garantuar që vlerësimi aktual është zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore.

IX. PËRFUNDIMI DHE KËRKESAT DREJTUAR AUTORITETIT KONTRAKTUES

Duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e paraqitura, konsiderojmë se vendimi për eliminimin e kompanisë sonë dhe rekomandimin e grupit të operatorëve ekonomikë për kontratë nuk është mbështetur në një vlerësim të plotë, objektiv dhe të argumentuar të dokumentacionit.

Eliminimi i ofertës sonë për dokumente që tashmë janë dorëzuar përbën një mangësi serioze në procesin e vlerësimit.

Në të njëjtën kohë, pretendimet lidhur me certifikatat ISO, analizën financiare, personelin menaxhues dhe licencat profesionale të grupit të rekomanduar kërkojnë shqyrtim të plotë dhe të paanshëm.

Për këto arsye, **KËRKOJMË** nga Organi Shqyrtues i Prokurimit:

1. Të aprovojë si të bazuar këtë ankesë.

2. Të anulojë vendimin e datës 23.10.2026 për eliminimin e ofertës sonë dhe rekomandimin për dhënie të kontratës, në pjesët e kontestuara.

3. Të kthejë aktivitetin e prokurimit në **Rivlerësim**, duke zbatuar dispozitat e nenit 59 të LPP-së dhe kriteret e dosjes së tenderit.

4. Të verifikojë dokumentet që kemi dorëzuar me ofertën tonë, veçanërisht dokumentet "12.Lista e punëtorëve me kontrata" dhe "7.Specifikimet teknike", dhe të konstatojë përmbushjen e kërkesave për të cilat jemi eliminuar, nëse përmbajtja dhe vlefshmëria e tyre e dëshmojnë këtë.

5. Të rivlerësojë përmbushjen e kritereve nga grupi MEB L.L.C. & KSF MAJOR SH.A., përfshirë fushëveprimtarinë e certifikatave ISO, analizën financiare, përvojën e menaxherit të projektit dhe certifikatat profesionale të kërkuara.

6. Të verifikojë nëse oferta e rekomanduar përmbush detyrimet **që burojnë nga Ligji i Punës, vendimi për pagën minimale dhe specifikimet teknike të detyrueshme**.

7. Të shqyrtojë në mënyrë të argumentuar nevojën për zbatimin e dispozitave që rregullojnë tenderët me çmime jonormalisht të ulëta.

8. Të na mundësojë qasje në dokumentacionin e ofertës së rekomanduar, përfshirë versionet e pastruara të dokumenteve që përmbajnë informacione të mbrojtura, në përputhje me dispozitat ligjore.

9. Të japë përgjigje të veçantë, konkrete dhe të argumentuar për secilin pretendim të paraqitur në këtë kërkesë, duke identifikuar dokumentet e shqyrtuara dhe dispozitat ligjore mbi të cilat mbështetet vendimmarrja.

10. Të ndërmarrë masat e nevojshme për të garantuar që procesi i mëtejshëm të zhvillohet në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë.

Në përfundim, theksojmë se kompania jonë nuk kërkon trajtim të privilegjuar dhe as shmangie nga kriteret e dosjes së tenderit. Kërkojmë vetëm që dokumentet tona të shqyrtohen realisht dhe që të njëjtat kërkesa ligjore dhe profesionale të zbatohen në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë ofertuesve.

Nuk mund të konsiderohet proces i drejtë i prokurimit publik një vlerësim në të cilin një operator ekonomik eliminohet për dokumente që gjenden në ofertën e tij, ndërsa për operatorin e rekomanduar nuk jepet arsyetim i mjaftueshëm lidhur me përmbushjen e kritereve të detyrueshme.

Presim që Organi Shqyrtues i Prokurimit t'i trajtojë këto pretendime me seriozitetin e nevojshëm dhe të korrigjojë mangësitë e evidentuara përmes një vendimmarrjeje të ligjshme dhe të argumentuar.

Me respekt,

SKYFTERAT–LIVE SH.P.K.

Bashkëngjitjet

1. Dokumenti "12.Lista e punëtorëve me kontrata".
2. Dokumenti "7.Specifikimet teknike", datë 15.10.2026.
3. Dëshmitë dhe certifikatat e MPB-së për punëtorët përkatës.
4. Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, datë 23.10.2026.
5. Letra standarde për eliminimin e SKYFTERAT–LIVE SH.P.K.
6. Kërkesa për qasje në dokumente dhe përgjigjja e AK-së, nëse është lëshuar.
7. Dokumentet e sqarimeve shtesë të publikuara gjatë muajit shtator 2026.
8. Vendimi përkatës i OSHP-së nga procedura e mëparshme, nëse është i disponueshëm.
9. Dëshmitë e tjera mbështetëse lidhur me pretendimet e paraqitura.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si palë e interesit në këtë aktivitet të prokurimit na janë krijuar shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit (ofertës) dhe pjesëve të tjera të cilat ndërlidhen me këtë aktivitet të prokurimit si: shpenzimet për përgatitjen e ankesave si në fazën e parë dhe atë të dytë, përfaqësimeve të cilat mund të ndodhin etj.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

"SKYFTERAT-LIVE" SH.P.K

Rr.Rexhep Bislimi 1, Ferizaj; skyfterat-live@hotmail.com; +383 48 100 800

DEKLARATË

PËR: KUVENDI KOMUNAL I LIPJANIT

NGA: "SKYFTERAT-LIVE" SH.P.K

LËNDA: DEKLARATË

DATA: 02.10.2026

Të nderuar

Përmes kësaj deklarate kompania jonë garanton se si kompani do të jemi në gjendje ti mbulojmë të gjitha objektet e Komunës. Lidhur me pagat e punëtorëve do të paguhen më së largu deri me datën 05 të muajit në vijim në vlerën bazë prej 500.00 euro bruto sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues.

Poashtu konfirmojmë gatishmërinë tonë t'i përgjigjemi Autoritetit Kontraktues në cdo kohë dhe moment për sigurimin e objekteve shtesë që mund të lindin si nevoj urgjente e Autoritetit Kontraktues - Kuvendi Komunal i Lipjanit.

Kompania jonë deklarohet se do ti rrespektoj të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore dhe të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

DREJTORI

SH.P.K. FERIZAJ

"SKYFTERAT-LIVE" SH.P.K

Rr.Rexhep Bislimi 1, Ferizaj; skyfterat-live@hotmail.com; +383 48 100 800

DEKLARATË

PËR: KUVENDI KOMUNAL I LIPJANIT

NGA: "SKYFTERAT-LIVE" SH.P.K

LËNDA: DEKLARATË

DATA: 02.10.2026

Të nderuar

Përmes kësaj deklarate kompania jonë garanton se si kompani do të përmbushim të gjitha të cekurat e Autoritetit Kontraktues në Aneksin 1 tek Specifikimet teknike të detyrueshme, për aktivitetin e prokurimit dhe se do ta realizojmë projektin sipas specifikimeve teknike dhe është në përputhje të plotë me kërkesat e specifikimeve teknike të detyrueshme.

Shpresojmë se kjo deklaratë është e mjaftueshme për ju sipas kërkesës suaj.

Me Rrespekt!

DREJTORI

SH.P.K. FERIZAJ

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme te objektit te kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe te operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar te vendos specifikime teknike qe favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose me shume operatorë ekonomik.

[2. Nëse variantet lejohen Autoriteti Kontraktues duhet te ceke specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga një variant dhe çdo kërkesë specifike për prezantimin e variantit të tillë.]

SIGURIMI I OBJEKTEVE

FUSHEVEPRIMI

Kompania do te siguroje rojtare sigurie te pajisur si duhet dhe te trajnuar mire, ne vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktues. Mbikëqyrësi i kompanisë do te garantoje qe rojet e sigurisë te kryejnë detyrën kryesore te mbrojtjes se punonjësve dhe pronës se Autoritetit Kontraktues (AK). Kompania do te siguroj te gjitha materialet dhe pajisjet e nevojshme te punës dhe te mbikëqyrjes për te kryer shërbimet ne te gjitha aspektet dhe garanton se te gjitha shërbimet do te kryhen me kohe dhe ne mënyre profesionale. Kompania do te caktoje një menaxher te këtij projekti qe te monitorojnë kualitetin e shërbimeve qe ofrohen dhe te shqyrtoj dështimet apo mangësitë ne ofrimin e shërbimeve qe i ofrohen AK.

Kompania duhet te ofroje gjithë çka nevojitet, ne përputhje me sigurinë e pa armatosur, për te mbrojtur punonjësit e AK, pronën e AK, dokumentacionin e AK dhe mbrojtjen tjetër sipas kërkesave nga zyrtaret përgjegjës pranë AK.

Këto shërbime përfshijnë vend-qëndrimet e sigurimit me përgjegjësitë ne vijim:

- Administrimi i procedurave te sigurisë ne lokacionin e objekteve te AK
- Kontrollimi ne hyrje i personave, automjeteve dhe pronës tjetër
- Vëzhgimi i lokacionit (ne këmbe ose me automjet)
- Identifikimi dhe raportimi i shkeljeve te sigurisë
- Mirëmbajtja e dosjeve qe kane te bëjnë me dokumentacionin e sigurisë
- Asistimi i personelit te AK ne situata emergjente
- Garantimi i veprimi te shpejte për parandalimin apo minimizimin e humbjeve nga aksidentet, zjarri, dëmtimet ne prone, rreziqet e sigurisë, shkeljet e sigurisë dhe veprimet e dyshimta
- Informimi mbi ngjarjet e veçanta qe ndodhin ne tere objektin dhe pronën

Rojtaret e sigurisë qe punojnë duhet te paraqiten ne pune me uniformat e siguruara nga kompania. Uniforma do te identifikoje qarte punonjësin si roje sigurimi qe punon për kompaninë, duke përfshire kartelën e identifikimit me fotografi. Uniforma duhet te jete e rregullt, e pastër, e hekurosur dhe te prezantoje pamje profesionale.

Rojtaret e sigurisë asnjëherë nuk duhet te braktisin objektit gjate turnit te tyre. Rojet e sigurimit duhet te sjellin shujtat e tyre te nevojshme për te ngrëne ne objekt.

Operatori Ekonomik duhet te garantoj se personeli i tyre do te kryejnë shërbime ne përputhje me kushtet e kontratës, ne interesin me te mire te AK. Ne te njëjtën kohe, Operatori Ekonomik duhet te garantoj te gjitha ndërtesat, hapësirat dhe te mirat materiale te AK do te jene te sigurta dhe te mbrojtura nga vjedhja, dëmtimi, zjarri apo rreziqet tjera.

Roja duhet te drejtoj komunikacionin ne objektet e AK duke evituar parkimin e veturave ne vendet ku është e

ndaluar parkimi i veturave.

Kompania duhet te mbaje librin e evidencës (regjistrimit se te dhënave) për çdo person qe hyn dhe del nga objektet e AK.

Kompania duhet te mbikëqyr gjithë pasurinë ne te gjitha objektet e AK duke ndaluar çdo person qe tenton te vjedhë ose keqpërdor ketë pasuri dhe duhet ti respektoj te gjitha shkresat, vendimet, udhëzimet e pranuara nga zyrtaret përgjegjës ne AK.

Angazhimi i rojeve shtesë
- kompania duhet çdo herë te jete e gatshme për ofrimin e rojeve shtesë.
- angazhimi i rojeve shtesë bëhet vetëm me kërkese te personit përgjegjës në AK

Zëvendësimi i rojeve
- Zëvendësimi i rojeve bëhet vetëm me njoftim dhe aprovim paraprak nga AK
- Koordinimi mes rojeve duhet të bëhet nga mbikëqyrësi i grupit i cili caktohet nga kompania
- Udhëzimet e përcaktuara për rojet duhet të jenë të njohura paraprakisht.

Ofruesi i Shërbimeve gjate realizimit te kontratës do te respektoj ***Ligjin e Punës Nr. 03/L-212*** në fuqi si dhe ***Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004***, të Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 27 te ligjit te punes - Orët e punës ndërmjet orës 22:00 dhe 6:00 numërohen si punë nate. Ndersa sipas nenit 56 të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë: 30 % në orë për punë gjatë natës; 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës.

Autoriteti Kontraktues gjate realizimit te kontratës gëzon te drejtën qe nëse vjen deri te hapja e ndonjë pike te re, te kërkoj nga Ofruesi i Shërbimeve qe shërbimet e sigurimit ti kryej edhe ne qendrat e hapura sipas kushteve te kontratës. Çmimi i pagesës për këto qendra do te jete çmimi për njësi i orës se shërbimeve sipas kontratës. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues gëzon te drejtën e kërkesës nga Kryesi i shërbimeve për ndërprerjen e kryerjes se shërbimeve te sigurimit ne rast te mbylljes se ndonjërës nga pikat qe janë pjese e specifikacionit teknik te kësaj dosje te tenderit.

Pjesa nr.	Përshkrimi i pozitës (a)	Numri total i orëve për ditë	Numri total i orëve për muaj numri i diteve ne muaj
1	Sigurimi fizik - ne objektin e ndertese e Komunes se Lipjanit (nga ora 08:00 e mengjesit deri në 16:00 në mbrëmje 3 punëtor të sigurimit fizik)	24	528
2	Sigurimi fizik - tek Auto parku - (oborri dhe rampa)	24	744
3	Sigurimi fizik - tek Qenrdra per pune sociale - Lipjan	24	744
4	Sigurimi fizik - tek Arkivi I qytetit - Lipjan	24	744
5	Sigurimi fizik - tek Zona Ekonomike në Qylagë	24	744

LISTA E STAFIT ME PARAKONTRATË PER: SKYFTERAT-LIVE SHPK

Nr.	Emri dhe Mbimeri	Nr. Personal	Adresa
1	Abaz Abazi	1015100393	BELINCE, Kacanik
2	Adem Dogani	1012494781	Kaqanik
3	Afrim Dashi	2002834327	Fsh.Stagove
4	Agim Dema	1012725031	Fsh.Bobe
5	Korab Berisha	1231359237	Rr. Rexhep Bislimi Ferizaj
6	Nehat Guri	1172479266	Fsh.Nikaj
7	Adem Mehmeti	1011782716	Rr.Vllezerit Gervalla
8	Admir Beqa	1030904750	Fsh.Varosh,Ferizaj
9	Avni Ugzmajli	1005592743	Rr.Ramadan Rexhepi ,Ferizaj
10	Avzi Sopa	1003272539	Kaqanik i Vjeter ,kaqanik
11	Besim Gavazi	1005951743	Fsh.Pleshine
12	Besnik Osmani	1230501781	Fsh.Sazli
13	Fisnik Uruqi	1244800927	Rr.Sharrit ,Ferizaj
14	Flamur Grainca	2002323977	Fsh.Cernille ,Ferizaj
15	Florim Karaliti	1005531523	Rr.Ganimete Terbeshi ,Ferizaj
16	Imer Salihi	1003791471	Fsh.Terrn ,Ferizaj
17	Kemal Shehu	1005394305	Fsh.Doganaj ,Kaqanik
18	Meriton Ahmeti	1241812355	Fsh.Greme ,Ferizaj
19	Musli Sefa	1018292846	Rr.Hamz Jashari ,Ferizaj
20	Naser Salihi	1030281906	Fsh.Terrn ,Ferizaj

SKYFTERAT-LIVE SHPK_____

NSyla SH.P.K. SECURITAS SKYFTERAT-LIVE FERIZAJ

PARAKONTRATË PUNE

e lidhur ndërmjet:

Punëdhënësit:
Kompania **"Skyfterat-Live" SH.P.K, NUI 811046540**, me seli në **Rr. Rexhep Bislimi, Nr. 1, Ferizaj**, e përfaqësuar nga **Njazi Syla** (në tekstin e mëtejmë: Punëdhënësi)

Dhe

Punëmarrësit: Emri dhe mbiemri: Abaz Abazi Nr. personal: 1015100393
Adresa: BELINCE, Shtime, (në tekstin e mëtejmë: Punëmarrësi)

Neni 1- Baza e kontratës

Kjo parakontratë lidhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës në fuqi në Republikën e Kosovës dhe rregullon marrëdhënien paraprake të punës për angazhim në projektin:

Titulli:
Sigurimi fizik dhe alarme të institucioneve komunale - Ritenderim

Nr.prokurimit:
613-26-7442-2-1-1

Neni 2- Pozita e punës

Punëmarrësi angazhohet në pozitën:
Punëtor i sigurimit fizik I objekteve te Komunes se Lipjanit dhe Shkollave dhe do te kryejn detyrat e punës pranë Kuvendit Komunal Lipjan.

Neni 3- Detyrat dhe përgjegjësitë

Punëmarrësi obligohet që të kryejë këto detyra:

- Sigurimin fizik të objekteve të Komunës së Lipjanit dhe institucioneve përkatëse
- Kontrollin e hyrje-daljeve në objekt
- Ruajtjen e rendit dhe sigurisë në hapësirat e përcaktuara
- Raportimin e çdo incidenti tek mbikëqyrësi
- Zbatimin e rregullave dhe procedurave të sigurisë

Neni 4- Kohëzgjatja

Kjo marrëdhënie pune parashihet të lidhet për një periudhë të caktuar prej:
3 (tri) **vite**, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës përfundimtare ndërmjet Punëdhënësit dhe autoritetit kontraktues (Kuvendi Komunal Lipjan).

Neni 5- Orari i punës

Orari i punës do të caktohet nga Punëdhënësi në përputhje me natyrën e punës dhe legjislacionin në fuqi, përfshirë punën me ndërrime (ditë/natë).

Neni 6- Paga

Punëmarrësi do të kompensohet me pagë mujore:
500 (pesëqind) Euro bruto

Pagesa do të bëhet në përputhje me legjislacionin tatimor dhe të punës në fuqi.

Neni 7- Të drejtat dhe obligimet

Palët zotohen të respektojnë:

- Të gjitha dispozitat e Ligjit të Punës
- Rregulloret e brendshme të Punëdhënësit
- Standardet profesionale të sigurisë

Neni 8- Hyrja në fuqi

Kjo parakontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dy palët dhe mbetet në fuqi deri në lidhjen e kontratës përfundimtare të punës.

Neni 9-Dispozitat përfundimtare:

Në rast të mosnënshkrimit të kontratës kryesore për arsye të pavarura nga Punëdhënësi, kjo parakontratë konsiderohet e pavlefshme pa pasoja juridike për palët.

Nënshkrimet: Punëdhënësi: NSyla Punëmarrësi: _____

Data: 17 / 04 / 2026, Ferizaj

SH.P.K. SECURITAS FERIZAJ

PARAKONTRATË PUNE

e lidhur ndërmjet:

Punëdhënësit:
Kompania **"Skyfterat-Live" SH.P.K, NUI 811046540**, me seli në **Rr. Rexhep Bislimi, Nr. 1, Ferizaj**, e përfaqësuar nga **Njazi Syla** (në tekstin e mëtejmë: Punëdhënësi)

Dhe

Punëmarrësit: Emri dhe mbiemri: Adem Dogani Nr. personal: 1012494781
Adresa: Kacanik, (në tekstin e mëtejmë: Punëmarrësi)

Neni 1- Baza e kontratës

Kjo parakontratë lidhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës në fuqi në Republikën e Kosovës dhe rregullon marrëdhënien paraprake të punës për angazhim në projektin:

Titulli:
Sigurimi fizik dhe alarme të institucioneve komunale - Ritenderim

Nr.prokurimit:
613-26-7442-2-1-1

Neni 2- Pozita e punës

Punëmarrësi angazhohet në pozitën:
Punëtor i sigurimit fizik I objekteve te Komunes se Lipjanit dhe Shkollave dhe do te kryejn detyrat e punës pranë Kuvendit Komunal Lipjan.

Neni 3- Detyrat dhe përgjegjësitë

Punëmarrësi obligohet që të kryejë këto detyra:

- Sigurimin fizik të objekteve të Komunës së Lipjanit dhe institucioneve përkatëse
- Kontrollin e hyrje-daljeve në objekt
- Ruajtjen e rendit dhe sigurisë në hapësirat e përcaktuara
- Raportimin e çdo incidenti tek mbikëqyrësi
- Zbatimin e rregullave dhe procedurave të sigurisë

Neni 4- Kohëzgjatja

Kjo marrëdhënie pune parashihet të lidhet për një periudhë të caktuar prej:
3 (tri) **vite**, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës përfundimtare ndërmjet Punëdhënësit dhe autoritetit kontraktues (Kuvendi Komunal Lipjan).

Neni 5- Orari i punës

Orari i punës do të caktohet nga Punëdhënësi në përputhje me natyrën e punës dhe legjislacionin në fuqi, përfshirë punën me ndërrime (ditë/natë).

Neni 6- Paga

Punëmarrësi do të kompensohet me pagë mujore:
500 (pesëqind) Euro bruto

Pagesa do të bëhet në përputhje me legjislacionin tatimor dhe të punës në fuqi.

Neni 7- Të drejtat dhe obligimet

Palët zotohen të respektojnë:

- Të gjitha dispozitat e Ligjit të Punës
- Rregulloret e brendshme të Punëdhënësit
- Standardet profesionale të sigurisë

Neni 8- Hyrja në fuqi

Kjo parakontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dy palët dhe mbetet në fuqi deri në lidhjen e kontratës përfundimtare të punës.

Neni 9-Dispozitat përfundimtare:

Në rast të mosnënshkrimit të kontratës kryesore për arsye të pavarura nga Punëdhënësi, kjo parakontratë konsiderohet e pavlefshme pa pasoja juridike për palët.

SH.P.K. SIGURIA FERIZAJ

Nënshkrimet: Punëdhënësi: NSyla Punëmarrësi: A. Dogan

Data: 17 / 04 / 2026, Ferizaj

PARAKONTRATË PUNE

e lidhur ndërmjet:

Punëdhënësit:
Kompania **"Skyfterat-Live" SH.P.K, NUI 811046540**, me seli në **Rr. Rexhep Bislimi, Nr. 1, Ferizaj**, e përfaqësuar nga **Njazi Syla** (në tekstin e mëtejmë: Punëdhënësi)

Dhe

Punëmarrësit: Emri dhe mbiemri: Afrim Dashi Nr. personal: 2002834327
Adresa: Fsh.Stragove, Kacanik, (në tekstin e mëtejmë: Punëmarrësi)

Neni 1- Baza e kontratës

Kjo parakontratë lidhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës në fuqi në Republikën e Kosovës dhe rregullon marrëdhënien paraprake të punës për angazhim në projektin:

Titulli:
Sigurimi fizik dhe alarme të institucioneve komunale - Ritenderim

Nr.prokurimit:
613-26-7442-2-1-1

Neni 2- Pozita e punës

Punëmarrësi angazhohet në pozitën:
Punëtor i sigurimit fizik I objekteve te Komunes se Lipjanit dhe Shkollave dhe do te kryejn detyrat e punës pranë Kuvendit Komunal Lipjan.

Neni 3- Detyrat dhe përgjegjësitë

Punëmarrësi obligohet që të kryejë këto detyra:

- Sigurimin fizik të objekteve të Komunës së Lipjanit dhe institucioneve përkatëse
- Kontrollin e hyrje-daljeve në objekt
- Ruajtjen e rendit dhe sigurisë në hapësirat e përcaktuara
- Raportimin e çdo incidenti tek mbikëqyrësi
- Zbatimin e rregullave dhe procedurave të sigurisë

Neni 4- Kohëzgjatja

Kjo marrëdhënie pune parashihet të lidhet për një periudhë të caktuar prej:
3 (tri) **vite**, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës përfundimtare ndërmjet Punëdhënësit dhe autoritetit kontraktues (Kuvendi Komunal Lipjan).

Neni 5- Orari i punës

Orari i punës do të caktohet nga Punëdhënësi në përputhje me natyrën e punës dhe legjislacionin në fuqi, përfshirë punën me ndërrime (ditë/natë).

Neni 6- Paga

Punëmarrësi do të kompensohet me pagë mujore:
500 (pesëqind) Euro bruto

Pagesa do të bëhet në përputhje me legjislacionin tatimor dhe të punës në fuqi.

Neni 7- Të drejtat dhe obligimet

Palët zotohen të respektojnë:

- Të gjitha dispozitat e Ligjit të Punës
- Rregulloret e brendshme të Punëdhënësit
- Standardet profesionale të sigurisë

Neni 8- Hyrja në fuqi

Kjo parakontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dy palët dhe mbetet në fuqi deri në lidhjen e kontratës përfundimtare të punës.

Neni 9-Dispozitat përfundimtare:

Në rast të mosnënshkrimit të kontratës kryesore për arsye të pavarura nga Punëdhënësi, kjo parakontratë konsiderohet e pavlefshme pa pasoja juridike për palët.

Nënshkrimet: Punëdhënësi: _____ Punëmarrësi: _____

Data: 17 / 04 / 2026, Ferizaj

PARAKONTRATË PUNE

e lidhur ndërmjet:

Punëdhënësit:
Kompania **"Skyfterat-Live" SH.P.K, NUI 811046540**, me seli në **Rr. Rexhep Bislimi, Nr. 1, Ferizaj**, e përfaqësuar nga **Njazi Syla** (në tekstin e mëtejmë: Punëdhënësi)

Dhe

Punëmarrësit: Emri dhe mbiemri: Agim Dema, Nr. personal: 1012725031
Adresa: Fsh.Bobe, Kacanik (në tekstin e mëtejmë: Punëmarrësi)

Neni 1- Baza e kontratës

Kjo parakontratë lidhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës në fuqi në Republikën e Kosovës dhe rregullon marrëdhënien paraprake të punës për angazhim në projektin:

Titulli:
Sigurimi fizik dhe alarme të institucioneve komunale - Ritenderim

Nr.prokurimit:
613-26-7442-2-1-1

Neni 2- Pozita e punës

Punëmarrësi angazhohet në pozitën:
Punëtor i sigurimit fizik I objekteve te Komunes se Lipjanit dhe Shkollave dhe do te kryejn detyrat e punës pranë Kuvendit Komunal Lipjan.

Neni 3- Detyrat dhe përgjegjësitë

Punëmarrësi obligohet që të kryejë këto detyra:

- Sigurimin fizik të objekteve të Komunës së Lipjanit dhe institucioneve përkatëse
- Kontrollin e hyrje-daljeve në objekt
- Ruajtjen e rendit dhe sigurisë në hapësirat e përcaktuara
- Raportimin e çdo incidenti tek mbikëqyrësi
- Zbatimin e rregullave dhe procedurave të sigurisë

Neni 4- Kohëzgjatja

Kjo marrëdhënie pune parashihet të lidhet për një periudhë të caktuar prej:
3 (tri) **vite**, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës përfundimtare ndërmjet Punëdhënësit dhe autoritetit kontraktues (Kuvendi Komunal Lipjan).

Neni 5- Orari i punës

Orari i punës do të caktohet nga Punëdhënësi në përputhje me natyrën e punës dhe legjislacionin në fuqi, përfshirë punën me ndërrime (ditë/natë).

Neni 6- Paga

Punëmarrësi do të kompensohet me pagë mujore:
500 (pesëqind) Euro bruto

Pagesa do të bëhet në përputhje me legjislacionin tatimor dhe të punës në fuqi.

Neni 7- Të drejtat dhe obligimet

Palët zotohen të respektojnë:

- Të gjitha dispozitat e Ligjit të Punës
- Rregulloret e brendshme të Punëdhënësit
- Standardet profesionale të sigurisë

Neni 8- Hyrja në fuqi

Kjo parakontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dy palët dhe mbetet në fuqi deri në lidhjen e kontratës përfundimtare të punës.

Neni 9-Dispozitat përfundimtare:

Në rast të mosnënshkrimit të kontratës kryesore për arsye të pavarura nga Punëdhënësi, kjo parakontratë konsiderohet e pavlefshme pa pasoja juridike për palët.

Nënshkrimet: Punëdhënësi: NSyla Punëmarrësi: _____

Data: 17 / 04 / 2026, Ferizaj

SH.P.K SECURITY ENGINEERING FERIZAJ

PARAKONTRATË PUNE

e lidhur ndërmjet:

Punëdhënësit:
Kompania **"Skyfterat-Live" SH.P.K, NUI 811046540**, me seli në **Rr. Rexhep Bislimi, Nr. 1, Ferizaj**, e përfaqësuar nga **Njazi Syla** (në tekstin e mëtejmë: Punëdhënësi)

Dhe

Punëmarrësit: Emri dhe mbiemri: Korab Berisha Nr. personal: 1231359237
Adresa: Rr. Rexhep Bislimi, Ferizaj, (në tekstin e mëtejmë: Punëmarrësi)

Neni 1- Baza e kontratës

Kjo parakontratë lidhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës në fuqi në Republikën e Kosovës dhe rregullon marrëdhënien paraprake të punës për angazhim në projektin:

Titulli:
Sigurimi fizik dhe alarme të institucioneve komunale - Ritenderim

Nr.prokurimit:
613-26-7442-2-1-1

Neni 2- Pozita e punës

Punëmarrësi angazhohet në pozitën:
Punëtor i sigurimit fizik I objekteve te Komunes se Lipjanit dhe Shkollave dhe do te kryejn detyrat e punës pranë Kuvendit Komunal Lipjan.

Neni 3- Detyrat dhe përgjegjësitë

Punëmarrësi obligohet që të kryejë këto detyra:

- Sigurimin fizik të objekteve të Komunës së Lipjanit dhe institucioneve përkatëse
- Kontrollin e hyrje-daljeve në objekt
- Ruajtjen e rendit dhe sigurisë në hapësirat e përcaktuara
- Raportimin e çdo incidenti tek mbikëqyrësi
- Zbatimin e rregullave dhe procedurave të sigurisë

Neni 4- Kohëzgjatja

Kjo marrëdhënie pune parashihet të lidhet për një periudhë të caktuar prej:
3 (tri) **vite**, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës përfundimtare ndërmjet Punëdhënësit dhe autoritetit kontraktues (Kuvendi Komunal Lipjan).

Neni 5- Orari i punës

Orari i punës do të caktohet nga Punëdhënësi në përputhje me natyrën e punës dhe legjislacionin në fuqi, përfshirë punën me ndërrime (ditë/natë).

Neni 6- Paga

Punëmarrësi do të kompensohet me pagë mujore:
500 (pesëqind) Euro bruto

Pagesa do të bëhet në përputhje me legjislacionin tatimor dhe të punës në fuqi.

Neni 7- Të drejtat dhe obligimet

Palët zotohen të respektojnë:

- Të gjitha dispozitat e Ligjit të Punës
- Rregulloret e brendshme të Punëdhënësit
- Standardet profesionale të sigurisë

Neni 8- Hyrja në fuqi

Kjo parakontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dy palët dhe mbetet në fuqi deri në lidhjen e kontratës përfundimtare të punës.

Neni 9-Dispozitat përfundimtare:

Në rast të mosnënshkrimit të kontratës kryesore për arsye të pavarura nga Punëdhënësi, kjo parakontratë konsiderohet e pavlefshme pa pasoja juridike për palët.

Nënshkrimet: Punëdhënësi: NSyla Punëmarrësi: _____

Data: 17 / 04 / 2026, Ferizaj

Republika e Kosovës/ Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Ministria e Punëve të Brendshme/ Ministarstvo unutrašnjih poslova/ Ministry of Internal Affairs

CERTIFIKATË /SERTIFIKAT /CERTIFICATE

I LËSHOHET/ IZDAJE SE ZA/ IS ISSUED FOR

KORAB G. BERISHA

Për dhënie me sukses të provimit shtetëror

TRAJNIM THEMELOR PROFESIONAL

